

---

**STATUTI DHE AKTI THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" INTERSMART" SH.P.K**

Ne zbatim te Ligiit Nr. 9901, dt 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", perpilohet Statuti i Shoqerise " **INTERSMART**" SH.P.K.

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i kesaj shoqerie private me pergjegiesi te kufizuar si dhe zhvillimi i metejshem i veprimtarise se saj.

**Neni 1:**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit:**

Sotme date 28/03/2022, Une themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegiesi te kufizuar, me emrin e vendosur " **INTERSMART**" SH.P.K Themeluesit e shoqerise jane:

Indrit Dollma, shtetas shqiptar, e datelindjes 21/07/1992, vendlindje ne Kruje, dhe vendbanim ne Rr., "Muhamed Deliu" , Tirane, me mjet identifikimi, ID nr.J207010161

**Neni 2 :**

**Objekti:**

Shoqeria do te kryeje aktivitetet te saj ne fushen e :  
Import-Eksport Mobiljesh –Prodhime dhe riparime, mobiljesh dhe orendish te ndryshme.  
Tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshim industrial.  
Veshje me tapiceri.

**Neni3:**

**Kohezgjatja:**

Shoqeria do te kryeje aktivitetet te saj me nje afat te papercaktuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 4 :**

**Selia :**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj kryesor me adrese ne: Rruga "Jordan Misja", Kompleksi Gener 2, Objekti E, Kati 0.

Ajo ka te drejte te krijojë brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise filiale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato. Cdo ndryshim i selise do te behet me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise. Shoqeria ka adrese elektronike per qellime komunikimi si vijon : intersmartshpk@gmail.com Shoqeria zoteron vulen e saj si dhe logon e saj zyrtare



---

**Neni 5 :**

**Kapitali :**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 000 leke .(sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me I vogel se 100 leke ). Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij te meposhtme:

1. Ortaku themelues : Indrit Dollma, zoterues i 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Percaktohet ketu se ortaket kane te drejte te kontribojne ne kuoten e tyre te pjesmarrjes,ne para apo ne natyre (duke transferuar pronesi te luajtshme apo te paluatjshme).

**Neni 6 :**

Kapitali I shoqerisee mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga te nje eksperti per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

**Neni 7 :**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferuashme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Ne rast vdekje te njerit prej ortakeve pjeset e kapitalit themelor qe disponon , i kalojne trashegimtareve te tij, dhe kur njeri nga pjestaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe u takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor.Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e detyrimet perkatese te ortakut.

**Neni 8 :**

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike i Shoqerise do te administrohet nga ortaket e shoqerise. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te githe detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.


**Neni 9 :**

Shoqeria eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale , duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet.

**Neni 10 :**

Shoqeria do te kete te hapur llogarine e saj rrjedhese ne Banke, nepermjet se ciles do te kryeje veprime ekonomike financiare me partner te trete vendas dhe te huaj, duke likujduar ne monedhe shqiptare apo te huaj, sipas marreveshjeve te perfunduara midis tyre.

**Neni 11 :**



---

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve.

Administratori i shoqense.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise. Ajo mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme thirret te pakten dy here ne vit, pas mbylljes se vitit financiar, dhe kur aprovohet programi i veprimtarise per vitin e ardhshem.

Asambleja e jashtezakonshme thirret kur administratori i shoqerise e quan te pershtatshme per kerkesat e shoqerise. I takon Asamblese te beje ndryshime ne Statutin e shoqerise , te pakesoj ose shtoj kapitalin themelor. Te shperndaje para afatit shoqerine ose te shtyje aktivitetin e saj.


**Neni 12 :**

Asambleja e ortakeve drejtohet nga Administratori i Shoqerise. I takon ketij te fundit te verifikoj rregullshmerine e pjesemarrjes se ortakeve. Cdo ortak mund te perfaqesohet ne Asamble nga nje tjetër ortak me ane te nje akti me delegim te nenshkruar sipas firmes se depozituar ne Librin e ortakeve. Per te mbajtur procesverbalin e mbledhjeve te Asamblese caktohet nje sekretar, qe mund te jete edhe nje noter. Vendimet e Asamblese duhen te nenshkruhen nga Administratori i Shoqerise, nga sekretari dhe nga te gjithë pjesemarrësit. Vendimet e Asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyruesme per te gjithë ortakët prezent ose jo.

**Neni 13 :**

Asambleja e Pergjithshrne emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë te shoqerisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistritimit në Qendrën Kombëtare të Regjistritimit. Keshtu, duke filluar nga data e miratimit te ketij statuti, Administrator i Vetem i shoqerise ” **INTERSMART**” SH.P.K, me nje afat 5 vjecar caktohet te jete :

Indrit Dollma, shtetas shqiptar, e datelindjes 21.07.1992, vendlindje ne Kruje, dhe vendbanim ne Rr., Muhamed Deliu”, Tirane, me mjet identifikimi, ID nr. J207010161


Specimenti Firmes: 

**Neni 14 :**

Administratorit te Shoqerise i takon administrimi i zakonshem i Shoqerise pervecse kur kjo gje sipas ligjit apo Statutit i rezervohet Asamblese se Ortakeve .

I takon Administratorit te shoqerise te perfaqesoje Shoqerine perpara te treteve dhe ne gjykim. Ai, gjithashtu gezon te drejten e firmes se Shoqerise.

Administratori mund ti delegeje te drejtat e veta nje personi te trete te autorizuar me shkrim per te perfaqesuar Shoqerine si dhe te kryej veprime dhe praktika te ndryshme ne emer te tij.

Indrit Dollme  


---

**Neni 15 :**

Asambleja e ortakeve te Shoqerise ka keto kompetenca dhe mund te marre keto vendime:

- Te miratoje programin e veprimtarise se Shoqerise , te hartoje raportet e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore

Vendos per shperndarjen e Shoqerise , per ndarjen e fitimit dhe mbulimn e humbjeve .

Rregullon marredheniet e punesimit dhe ato te shperblimit brenda Shoqerise.

Emeron dhe shkarkon administratore, eksperte kontabel, ben ndryshime e plotesime ne statut dhe ne kontraten e thernelimit , vendos per rritjen ose zvogelimin e kapitalit themelor, kalimin e kapitalit te treteve , ndryshimin e kohes se veprimtarise , shnderimin e shoqerise ne nje forme tjeter, likujdimin e Shoqerise.

Sipas akteve ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore, personave juridik ose fizik vendas ose te huaj.

**Neni 16:**

Kontrolli financiar i shoqerise kryhet nga nje ose me shume Auditues Ligjor sipas ligjit ose Financier te emeruar nga asambleja e ortakeve, per te kryer kontrole periodike si mbylljet vjetore te llogarive. Ne perfundim te kontrollit, Audituesi Ligjor ose Financieri pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit vjetor.

**Neni 17 :**

Cdo vit financiar fillon me 1 janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti,me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e regiistrimit te shoqerise.

**Neni 18 :**

Llogarite vjetore, inventaret, raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuar nga administratoret apo ekspertet kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve.Miratimi i dokumentave financiar vjetore behet brenda nje afati 3-mujore,mbas dates se shlyrjes se vitit financiar.

**Neni 19 :**

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit,Asambleja e ortakeve vendos krijimin e fondit ligjor,por mund te krijojte dhe fonde te tjera. Shoqeria perqiegiet per kontributin fiskal,afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore etj. Ajo ka te drejte te cele llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprime likujduese prane tyre.

**Neni 20:**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron me 31 dhjetor te cdo viti.Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin VJETOR dhe deklarimin e te ardhurave e tl depozitotjne ne organin financiar te Zyres se Tatimeve.

*Indrit Ballue*

---

**Neni 21 :**

Shoqeria mund te prishet para afatit te caktuar ne kete statut ne rast kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te parakoshme per shkaqe te tjera. Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin Asamblese se ortakeve rezultatet perfundimtare te likujdimit. Ne perfundim Asambleja e Ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre. Te gjitha detyrimet qe dalin nga akti i likujdimit Asambleja e ortakeve i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e ortakeve te shoqerise.

**Neni 22 :**

Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim brenda shoqerise si dhe shoqeria me te tretet apo midis vete ortakeve do te zgjidhen nepermjet Gjykates se Rrethit Tirane.

**Neni 23 :**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Ceshtjet e tjera te pa trajtuara ne kete statut do te mbeshteten per zbatim ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas rastit konkret.

**Neni 24 :**

Ndryshimi i formes se shoqerise ne nje shoqeri me nje forme tjeter tregtare behet me vendim te asamblese se ortakeve, kur plotesohen kushtet per krijimin e llojeve te tjera.

**Neni 25 :**

Asambleja e shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne cdo kohe ne statut pa rrene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane pershkruar ne kete statut.

**Neni 26 :**

Statuti eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te paleve, te ortakeve themelues dhe eshte nenshkruar prej tyre.

Statuti redaktohet ne pese kopje per tu shperndare Organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

***ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE " INTERSMART" SH.P.K***

**Indrit Dollma**

*Indrit Dollma*  
